

AKT- THEMELIMI
I SHOQËRISË TREGËTARE ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“BIG DRINA” SHPK.

Midis:

1. Shoqëria **“BIGALB GROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar, me Nipt **L11521002M** dhe seli në Tiranë, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Çash & Carry, kati 2, me përfaqësuese Ligjore **Znj. Elona Koshi**, e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, lindur në Gramsh, Shqipëri dhe me banim në Tiranë, rruga “3 Dëshmorët”, Yzberisht, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499, lëshuar më datë 06.06.2017.
2. Shoqëria **“B-IDEALGROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar, me Nipt **M31722025S** dhe seli në Tiranë, Rr “Dervish Hima”, Nr pasurie 6/369- N5 Zona Kadastrale 8160, përballë Ambasadës Amerikane, me përfaqësues ligjor **Z. Vladimir Lleshaj**, i biri i Vlashit dhe i Dilës, lindur më 08.04.1978 në Prosek, Mirditë, Shqipëri, dhe me banim në Tiranë, rruga “Hysen Çino”, Nd:27, H.1, Njësia Administrative Nr.2;1010, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. Pers H80408150T, lëshuar më datë 29.10.2019;
3. **Znj. Diana ZEBI**, e bija e Faizit dhe e Hatixhes, e datëlindjes 24.01.1963, lindur dhe banim në Tiranë, në adresën sheshi “Jozef San Martin”, P.3, Ap.9, Njesia Bashkiake nr.5, K. 1019, Tiranë, me kombësi dhe shtetësi shqiptare, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID nr personal G35124030C, lëshuar më datë 12.12.2014;

Në bazë të legjislacionit shqiptar kanë vendosur me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, marrëveshjen për themelimin e shoqërisë tregtare private, me përgjegjësi të kufizuar, të emërtuar **“BIG DRINA” SHPK**, e cila do të rregullohet në mbështetje të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe normave që vijnë:

Neni 1

Te themelojë një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “BIG DRINA” SHPK, që këtu e në vijim “Shoqëria”.

Shoqëria është një subjekt juridik Shqiptar, të cilit i lind e drejta të ushtrojë aktivitetin që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit të saj.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjegjësi të kufizuar dhe përballon humbjet sipas ligjit.

Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik të shoqërisë do të jetë:

- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm të të gjitha llojeve me pakicë si:
- Tregëtim artikuj të ndryshëm industrial;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm ushqimore;
- Tregëtim artikuj të ndryshëm bujqësore e blegtorale;
- Tregëtim fruta – perime;
- Tregëtim pije alkolike të ndryshme;
- Tregëtim konfeksione të ndryshme për të rritur dhe fëmijë;
- Tregëtim prodhimesh kozmetike e estetike;
- Tregëtim mallrash të të gjitha llojeve brenda dhe jashtë vendit;
- Tregëtim automjeteve të çdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjesë këmbimi për to;
- Tregëtim, montim, riparim paisjesh elektro-shtëpiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyresh etj;
- Hapje dhe shfrytëzim hotelesh, motelesh, diskotekash, bar-kafe, lojra argëtuese për fëmijë, qendër sportive, qendra pushimi e kurative;
- Tregëtimin e karburanteve të ndryshëm me pakicë, si dhe vajrave lubrifikante, të gazit të lëngshëm për ngrohje, pajisje ngrohëse gazi si dhe mbushjen e bombolave të gazit dhe tregëtimin e tyre me pakicë.
- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm kancelarik, libra, revista etj

Neni 4

4.1 Shoqëria e ka selinë e saj në adresën: Kati 0, godina me Zhvillues dhe Subjekt ndërtues shoqëria "Alkon" shpk. "Rruga "Inajete Dumi" dhe "Mustafa Mara", Nj. Strukturore TR/61 Tiranë. **ZONA KADASTRALE NR.8190, TIRANË.**

4.2 Shoqëria ka të drejtë të krijojë brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, degë, filiale, agjensi, si dhe ti suprimojë ato.

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë **10.000.000 (dhjetë milionë)** lekë dhe është i përbërë nga shumata në të holla e derdhur nga ortakët.

Neni 6

5.1 Kapitali fillestar i shoqërisë është **10.000.000 (dhjetë milionë)** lekë, i përbërë nga kontributet e ortakëve si më poshtë:

| Emri | Kuota | Përqindja | Kontributi në lekë |
|--------------|-------|-----------|--------------------|
| BIGALB GROUP | 1 | 40 % | 4 000 000 lekë |
| B-IDEALGROUP | 1 | 40% | 4 000 000 Lekë |
| DIANA ZEBI | 1 | 20% | 2 000 000 Lekë |

Neni 7

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në cdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 8

I gjithë kapitali i vënë nga të dy ortakët themelues është plotësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm nga ana e tyre.

Neni 9

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregëtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga të dy ortakët. Rritja e kapitalit themelor të shoqërisë nuk është e kufizuar.

Neni 10

Të ardhurat e realizuara nga shoqëria do të ndahen pjesërisht ose totalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të tyre të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar si dhe nëpërmjet akteve të tjera noteriale apo kontratave të punës që ata do të realizojnë, pasi të jetë lënë një shumë mënjane të paktën sa një e njëzeta e tij e cila destinohet për formimin e fondit rezervë.

Neni 11

Ne kohën e prishjes së shoqërisë ose të përfundimit të afatit, kur nuk ka zgjatje afati, kapitali i shoqërisë pasi të hiqen debitë e saj do të ndahet proporcionalisht ndërmjet ortakëve sipas kuotave të pjesëmarrjes në kapitalin themeltar.

Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqërisë, pas shlyerjes së detyrimeve ligjore dhe ato që kanë lindur me të tretët, është plotësisht i transferueshëm dhe për tu depozituar në një nga Bankat Shqiptare, ose për tu përdorur sipas nevojave të ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Ortakët kanë këto të drejta dhe detyra themelore:

- të derdhin kuotën e kapitalit bazë sikundër është përcaktuar në nenin 6,
- të marrin pjesë në drejtimin e shoqërisë,
- të tërheqin fitimin e realizuar,
- të tërheqin aktivin resultant nga bilanci i likuidimit në rast të pushimit të aktivitetit të shoqërisë,
- të ruajnë sekretin e aktivitetit të shoqërisë,
- të impenjohen për arritjen e objektivave të shoqërisë.

Neni 14

Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve të shoqërisë
- Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë

Administratore e shoqërisë do të jetë Znj. Denisa TUZI, shtetase shqiptare, lindur më 20.06.1994 në Krabë Tiranë dhe me banim në Tiranë, madhore dhe me zotësi juridike për të vepruar, mbajtëse e ID Nr: 039257501 dhe Nr. Personal J45620075A, lëshuar më datë 19.01.2024. Administratorja emrohet për një afat 5 vjeçar.

Neni 15

Shoqëria është person juridik shqipëtar dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj ekonomike private në bazë të legjislacionit shqipëtar në fuqi dhe veçanërisht ligji 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, të K. Civil si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Neni 16

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TË PUNËS), si dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Neni 17

Mosmarrëveshjet e mundëshme që mund të lindin gjatë interpretimit apo zbatimit të kësaj kontrate palët do t'i zgjidhin në rrugë miqësore, në të kundërt kompetencat për zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykatës së Rrethit Gjyqësor përkatës.

Neni 18

Për sa nuk përshkruhet në këtë kontratë themelimi do të aplikohen nenet e statudit të shoqërisë dhe dispozitat e legjislacionit shqipëtar.

Neni 19

Ky Akt-themelimi është përpiluar në tre kopje origjinale.

Datë 03/06/2024


ORTAKËT THEMELUES

Shoqëria “BIGALB GROUP” Sh.p.k.

Z. Vullnet Sinaj
Person i Besuar
Znj. Elona Koshi

Elona Koshi

[Signature]



Z. Vladimir Lleshaj

Vladimir Lleshaj

Znj Diana Zebi

DIANA ZEBI

[Signature]